

VENDIM
Nr. 324, datë 22.7.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 7,
DATË 21.12.2018, “RREGULLORE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARËVE TË GJYKATAVE”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 e 117, të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 61, 90, pika 1, shkronja “ë” dhe 97, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe nenit 26, pika 6, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 7, datë 21.12.2018, “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. Neni 3, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatës zgjedh zëvendëskryetarin, ndërmjet gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën në atë gjykatë, për një mandat trevjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme”.

ii. Neni 5, ndryshohet si më poshtë:

Në fjalinë e dytë, të pikës 1, togfjalëshi “të paktën dy të tretat” zëvendësohet me togfjalëshin “ shumica”.

iii. Neni 7, pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rastet kur nuk konkurrojnë kandidatë që plotësojnë kriterin e përvojës minimale profesionale ose kur asnjë nga gjyqtarët e gjykatës nuk e ka këtë përvojë, zëvendëskryetari i gjykatës zgjidhet ndërmjet gjyqtarëve të tjerë, që ushtrojnë funksionin në atë gjykatë, për një mandat njëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.”.

iv. Pas nenit 8 shtohet neni 9 me këtë përmbajtje:

“Neni 9

Dispozitë kalimtare

Përfundimisht, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas ligjit, kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së shkallës së parë duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar, ndërsa kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së apelit duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar i gjykatës së apelit.”.

2. Ngarkohen gjykatat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami